

KLSH merr pjesë në “Fellowship Program” të Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare të SHBA-së GAO

Në periudhën 3 maj - 28 korrik 2023, Kontrolli i Lartë i Shtetit ishte sërish pjesë e “*Fellowship Program*” të Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare të SHBA-së (U.S.GAO), së bashku me



Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) të Greqisë, Sllovakisë, Singaporit, Japonisë, Ugandës, Arabisë Saudite dhe Gjeorgjisë. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë z.Redi Ametllari, auditues.

Ky Programi është krijuar për të forcuar aftësinë e SAI-ve për të përmbushur misionet e tyre dhe për të rritur llogaridhënien dhe promovuar qeverisjen e

mirë në mbarë botën. Si anëtar-lider i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), GAO e inicioi këtë program në 1979 në përgjigje të rritjes së shpenzimeve të qeverisë federale jashtë vendit dhe nevojës që lidhet me të për të forcuar llogaridhënien mbi këto fonde. Gjatë programit të të mësuarit intensiv 3-mujor, pjesëmarrësit trajnohen mbi një sërë teknikash dhe qasjesh auditimi për të kryer auditime me cilësi të lartë. Për këtë qëllim, nga pjesëmarrësit kërkohej hartimi i një teme studimore mbi eksperiencën e përfutur në GAO, ku nga përfaqësuesi i KLSH-së u përgatit tema me titullin “*Parimet e të shkruarit të GAO-s për KLSH: Si të hartojmë një raport efektiv auditimi*”.

Në ditën e parë të çeljes së programit pjesëmarrësit u pritën nga Krye-kontrollori i Përgjithshëm i SHBA-së, z.Gene L.Dodaro, i cili vuri theksin mbi rëndësinë e programit të trajnimit në forcimin e kapaciteteve të SAI-ve pjesëmarrëse.



Z.Dodaro vlerësoi përkushtimin dhe angazhimin e SAI-ve përkatëse për të qenë pjesë e këtij trajnimit, duke nënvizuar se programi i trajnimit është një forum i rëndësishëm i shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira për të adresuar sfidat e reja të auditimit, në kontekstin e luftës kundër korrupsionit, zhvillimeve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe dixhitalizimit të shërbimeve qeveritare.

Programi i trajnimit i organizuar nga GAO pati një natyrë multidimensionale, i ndërthurur me aktivitete të rëndësishme, siç është Konferenca Vjetore Ndërqeveritare e Audituesve të SHBA-së, ku marrin pjesë auditues të nivelit federal, nivelit të shteteve dhe

inspektorët e përgjithshëm të SHBA-së. Po në këtë kontekst, ishte edhe pjesëmarrja në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kongresit Amerikan, ku GAO raportoi mbi auditimet e kryera në fushën e sigurisë në kufirin jugor të SHBA-së.



Njohja me kulturën dhe sistemin qeverisës së SHBA-së ishte një tjetër komponent i programit të trajnimit. Për këtë qëllim, GAO organizoi për pjesëmarrësit vizita, ndër të tjera, në Kongres, në Librarianë e Kongresit dhe në Gjykatën Supreme të SHBA-së.

Një tjetër element i rëndësishëm ishte edhe shkëmbimi kulturor midis pjesëmarrësve, ku në selinë qendrore të GAO-s u zhvillua panairi kulturor, që u mundësoi SAI-ve përkatëse të prezantonin kulturën dhe traditat e shtetit të tyre.

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e temës studimore si dhe u zhvillua ceremonia e diplomimit, në prezencën e drejtuesve të lartë të GAO, si Zyrtarja e Lartë Operacionale e GAO-s (COO), znj.Orice Williams Brown, Drejtori i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit të Jashtëm, z.Stephen Sanford, Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, Z.Mike Hix dhe Drejtori i Komunikimit z.Chuck Young.